

AUDITIMI I PROKURIMEVE PUBLIKE: NDIHMË APO NDËSHKIM?¹

nga Albana Gjinopulli

Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve për sektorin publik është thelbësor në veprimtarinë e çdo qeverie, ndaj me rritjen e prokurimeve për shpenzime publike, nevoja për një mbikëqyrje efektive nga institucionet audituese bëhet gjithnjë e më imediate. Vëllimi i tregut të prokurimeve publike në vendet anëtare të OECD zë rreth 10-15 % të Produktit të Brendshëm Bruto, ndërkohë që në vendet në zhvillim me ekonominë në tranzicion ai arrin deri në 25-30% të tij.

Megjithë faktin se sistemet e prokurimeve publike mund të ndryshojnë nga njëri vend në tjetrin, përsëri objektivat e përgjithshme mbeten të njëjta dhe këto kanë të bëjnë me: ***përgjegjshmërinë , efektivitetin dhe transparencën*** me të cilën prokurimi i fondeve publike bëhet në çdo vend.

Të paktën në dekadën e fundit, problemet lidhur me përmirësimin e sistemeve kombëtare të prokurimeve janë bërë pjesë e rëndësishme e axhendës së organizatave ndërkombëtare autoritare si Kombet e Bashkuara (UN), Organizata për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik (OECD), Banka Botërore(WB), Organizata Botërore e Tregtisë (WTO), Organizata për Siguri dhe bashkëpunim në Evropë (OSCE) dhe Dhoma ndërkombëtare e Tregtisë. P.sh, *Artikulli 9 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit* në vitin 2003 obligon shtetet ratifikuese të marrëveshjes të ndërmarrin” masat e nevojshme për të krijuar sistemet e duhura të prokurimeve bazuar në kriteret e transparencës, konkurrencës dhe objektivitetit në vendimmarrje”. Për më tepër, deklarata zyrtare të shteteve pjesëmarrëse të G20 në Samitin e Los Cabos në vitin 2012 ka vendosur

vlërësimin e pavarur të sistemeve kombëtare të prokurimeve publike si një nga pesë kërkesat e këtij samiti.

Por rëndësia e prokurimit publik nuk mund të matet vetëm në numra. Mënyra se si një qeveri realizon prokurimin e veprimtarive të saj shpesh reflekton kontratën sociale ndërmjet shtetit dhe qytetarëve të tij. Është e vërtetë se dëmi që mund të shkaktohet nga vjedhja dhe korrupsioni në prokurimet me vlera të vogla mund të jetë më i vogël se në prokurimet me vlera marramendëse, por fenomeni mbete po ai, vjedhja dhe korrupsioni mbetet i njëjtë edhe nëse bëhet fjalë për 10 lekë apo për 10 milionë. Kështu kur ka korrupsion pak rëndësi ka nëse vlera është e vogël apo e madhe, i rëndësishëm dhe problematik është fakti që vjedhja dhe abuzimi me fondet e taksapaguesve ka ndodhur. Sistemet e prokurimit janë gjerësisht të krijuara si rezultat i një procesi politik që balancon kërkesat konkurruese për vlera të përgjegjshmërisë, efektivitetit, ndershmërisë me vlera të tjera. Çdo shtet i vendos këto balanca sipas kushteve, nevojave dhe prioriteteve individuale të tij. Për shembull, disa vende mund të vendosin në plan të parë ofrimin në kohë të mallrave dhe shërbimeve, ndërkohë që disa të tjerë kanë në fokus luftën kundër korrupsionit. Në shumë vende, sistemi i prokurimeve nuk është thjesht një mjet për të blerë mallra dhe shërbime por gjithashtu një mekanizëm për të përmbushur objektiva të ndryshme politike. Dihet që të gjitha qeveritë tashmë “luftojnë” nën presionin e deficitit buxhetor dhe po përballen me sfida gjithnjë e më të mëdha. Zhvillimi ekonomik përballlet me vuajtje. Zbatimi i projekteve ndërkombëtare duke filluar që nga infrastruktura e deri në ndihmat në raste fatkeqësish natyrore mund të jetë në rrezik. Dhe c’është më e rëndësishmja, besimi i publikut në aftësinë që qeveria funksionon efektivisht mund të shkojë drejt rënies

Rruga drejt së ardhmes

Jo të gjithë problemet të sipërpërmendura mund të adresohen dhe për më tepër të zgjidhen nga auditimi. Por është e qartë se auditimi ka një rol të rëndësishëm për të luajtur në këtë drejtim dhe për këtë i duhen kapacitete dhe burime të afta. Në këtë kontest qëllimi strategjik i KLSH është të vlerësojë efektivitetin e prokurimeve në plotësimin e nevojave të publikut. Deri tani KLSH ka eksperiencë në auditimin e prokurimeve publike. Por shume më tepër mund të ishte bërë dhe duhet bërë. Prokurimi publik si një proces me risk të lartë i përball audituesit me sfida të njëpasnjëshme, ndaj në praktikën e administrimit publik ai konsiderohet të jetë një nga fushat më komplekse të auditimit. Si keqpërdorni i fondeve publike ashtu dhe ofrimi i shërbimeve publike me cilësi të ulët kontribuojnë negativisht në objektivat, misionin dhe integritetin e subjekteve publike. Ndaj auditimet rigoroze të prokurimeve dhe kontratave luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e efikasitetit të administrimit të fondeve publike. Audituesit duhet të jenë të mirëpërgatitur dhe të pajisur me njohuritë e nevojshme për të identifikuar dobësitë, për të vlerësuar risqet në prokurime me qëllim që të japin siguri se paratë taksapaguesve në qeverisje janë përdorur me ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet si dhe për qëllimin për të cilin ato janë dhënë. Objektivat e auditimit të prokurimeve publike përfshijnë: dhënie e garancisë që procesi i blerjes së mallrave dhe shërbimeve është siguruar në kohë, në sasinë, cilësinë dhe me burimet e duhura si dhe të sigurojë se prokurimi i ka përmbushur objektivat dhe qëllimin për të cilin është kryer. Kjo përfshin çdo fazë të procesit të prokurimit duke filluar që nga përcaktimi i kërkesës deri në vendosjen dhe përdorimin e mallrave apo shërbimeve të prokuruar. Është e rëndësishme të vlerësohet nëse prokurimi është kryer me kushte konkurrence të ndershme dhe mbi të gjitha që procesi ka siguruar vlerën e parasë

Ndaj një vëmendje e tillë mbi çështjet e prokurimit publik nga komuniteti ndërkombëtar nuk është aksidentale. SIGMA si një iniciativë e përbashkët e OECD dhe BE, për forcimin e sistemeve të qeverisjes publike dhe kapaciteteve administrative të vendeve kandidate për anëtare në BE , ka ndërmarrë një tërësi veprimtarish trajnuese në mbështetje të KLSH pjesë e të cilave ka qenë dhe trajnimi në fushën e prokurimeve publike. Për t'u përballur me sfidat që dalin nga ambjenti mjaft kompleks i prokurimeve publike është thelbësore për audituesit të jenë të informuar dhe të zotërojnë njohuri të cilat janë të domosdoshme për analizën dhe vlerësimin e sistemeve të prokurimit publik, mjete dhe metodologji bashkëkohore të cilat duhet të udhëheqin punën e tyre audituese. Për këtë qëllim është e domosdoshme të marrin njohuri teorike, praktike, të shkëmbejnë eksperiencën rreth vështirësive praktike më të zakonshme si dhe keqinterpretimet e mundshme në kontrollin e prokurimeve. Parime që udhëheqin auditimet e prokurimeve janë pjesë dhe në pajtueshmëri të plotë me parimet themelore të auditimit të INTOSAI-t. Këto parime pasqyrojnë objektivat themelore të përbashkëta për sistemet e prokurimeve publike dhe sigurojnë një kuadër udhëheqës që i mundëson komunitetit të auditimit të mbajë qeverinë të përgjegjshme në realizimin e këtyre objektiveve. Duke pasur parasysh volumin e tregut të prokurimit publik dhe të kompleksitetin e çështjeve në këtë fushë shumë të ndjeshme, duket e arsyeshme vendet anëtare të INTOSAI-it janë të angazhuar në nivel global për të zhvilluar qasje të koordinuara dhe parime përbashkëta për auditimin e prokurimeve publike. Kjo ide është shtruar nga Institucione homologe të Auditimit , anëtare të INTOSAI-t dhe është përkrahur nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Në veçanti , KLSH i kushton vëmendje sigurisë së integritetit të institucioneve publike, transparencës së procesit të prokurimit, menaxhimit të riskut dhe të gjitha këto në funksion të parandalimit të mashtrimit dhe korrupsionit. Auditimi i prokurimeve publike nuk duhet të

mbetet në kuadrin e ngushtë të kërkesave për ndëshkim, të cilat jo rrallëherë janë neglizhuar me papërgjegjshmërinë më të papranueshme nga institucionet shkelëse të ligjit. Thelbësore për të konsideruar se auditimi ka përmbushur me sukses objektivin e tij , është t'i shtojë vlerë dhe kjo arrihet nëpërmjet dhënies së rekomandimeve lidhur me përmirësimin e sistemit, me mënjanimin e shkakut i cili do të sjellë mënjanimin e pasojës, pra në frenimin e kthimit të ngjarjeve të padëshirueshme në fenomene.

Ky konsiderohet tashmë si pjesë e rolit të ri dhe modern të auditimit, duke qenë jo vetëm konstatues i çfarë ka ndodhur por mbi të gjitha të luftojë korrupsionin në thelb, dhe për më tepër ta parandalojë atë.

ⁱ Botuar në Gazetën "Republika" dt. 09 Nëntor 2013